

Prishtinë, 12 mars 2020

Udhëzime rreth masave parandaluese për Coronavirus (COVID-19)

Situata e shkaktuar nga Coronavirusi (COVID-19) vazhdon të përkeqësohet. Dje, më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e shpalli këtë virus si pandemi, që do të thotë se virusi tashmë është duke u shpërndarë në nivel global dhe ka prekur pjesë të konsiderueshme të popullësisë së planetit.

Deri sot, Kosova ende nuk ka konstatuar ndonjë rast të prekur nga ky virus, duke mbetur vendi i vetëm në Europë, së bashku me Malin e Zi, që kanë mbetur ende të paprekur. Megjithatë, për shkak që i njëjti tashmë është paraqitur në të gjitha vendet tjera europiane, përfshirë ato fqinje, edhe Kosova është jashtëzakonisht e rrezikuar.

Qeveria e Kosovës, duke reaguar pas shpalljes së pandemisë nga ana e OBSH, mbrëmjen e 11 marsit poashtu i mori masat e para kufizuese në mase, duke mbyllur shkollat, kufizuar lëvizjet e udhëtarë(e)ve me vendet e prekura dhe shtuar kontrollet kufitare, kufizuar tubimet publike, dhe një sërë masash tjera. Gjithashtu, edhe pse të kufizuara, studimet dhe analizat e deritashme të reagimeve ndaj Coronavirusit, por edhe epidemive të ngjashme në të kaluarën tregojnë që kufizimi i "ndërveprimit social" është masa më e efektshme parandaluese e cila ka efekt të drejtpërdrejtë në minimizimin e rasteve të të prekurëve dhe atyre fatale.

Duke qenë që prezenca jonë fizike nuk është vitale në situata emergjente, dhe bazuar në më sipër, KCSF ka hartuar një plan emergjent për përballimin e kësaj situatë, i cili përmban udhëzimet si në vijim:

1. Udhëzohen të gjithë të punësuarit/at që **të punojnë nga shtëpitë e tyre**, duke filluar nga sot, 12 mars 2020, përveç rasteve kur është e domosdoshme prezenca në zyrë;
2. Udhëzohen të gjithë mbikëqyrësit/et që vartësve të vet **t'ua sqarojnë të gjitha detyrat, afatet dhe informatat tjera** për ta vazhduar punën nga shtëpitë, për të paktën 1 javë, dhe këtë ta përsërisin përdërisa të vazhdojë gjendja e njëjtë;
3. Për mbarëvajtjen e punës nga shtëpia, udhëzohen të gjithë mbikëqyrësit/et që **të komunikojnë me rregull dhe të sigurojnë kordinimin e nevojshëm** me vartësit/et e tyre dhe ndërmjet vartësve, si dhe të informohen për gjendjen shëndetësore të secilit/ës vartës/e;
4. Për çfarëdo informate, këshille apo udhëzimi të lidhur me detyrat specifike të punës, të punësuarit/at duhet t'i drejtohen menjëherë mbikëqyrësit/es së vet;
5. Për çfarëdo informate, këshille apo udhëzimi të lidhur me aspektet shëndetësore apo të tjera të lidhura me KCSF-në në përgjithësi, të punësuarit/at duhet t'i drejtohen menjëherë Drejtores për Administratë dhe Financa;
6. Në parim, nga të punësuarit/at pritet që punën nga shtëpia ta bëjnë në **orarin e njejtë me orarin e punës**, me përjashtim të prindërve që përkujdesen për fëmijët e tyre të vegjël, që këtë mund të jenë fleksibil në orar pasi që t'i kenë njoftuar mbikëqyrësit/et;
7. **Rastet kur është e domosdoshme prezenca në zyrë** përfshijnë vetëm ato raste të cilat në asnjë rrethanë tjetër nuk mund të kryhen jashtë zyrës dhe kërkojnë qoftë qasje në infrastrukturën që nuk mund të bartet jashtë zyrës apo takime të drejtpërdrejta me kolegë/e të tjerë/a ose palë të treta;
8. Edhe pse ulja e numrit të atyre prezent në zyrë e ul dukshëm rrezikun ndaj ekspozimit dhe shpërndarjes së virusit, për të minimizuar këtë rrezik kërkohet nga të punësuarit/at që dalin në zyrë që:

- a. Të evitohen maksimalisht **takimet e drejtpërdrejta** ndërmjet vete;
 - b. Të mbajmë **distancën e kërkuar** (min.1 metër) ndërmjet vete;
 - c. Të kenë kujdes të shtuar për **higjienën e hapësirave të zyrës**;
 - d. Të zbatohen me përpikmëri të gjitha **këshillat e higjienës personale** dhe të tjera që tashmë janë vendosur në zyrat e KCSF-së.
9. Të punësuarit/at që mund të kenë **simptoma që ndërlidhen me Coronavirus** (ethe, kollitje, temperaturë të lartë ose pengesë në frymëmarrje) obligohen që të qëndrojnë në shtëpi deri sa të shërohen plotësisht, dhe atë të paktën 24 orë pas largimit të simptomës së fundit. Në rast të përkeqësimit të këtyre simptomave, udhëzohen të punësuarit/at që të drejtohen për qendrat shëndetësore përkatëse;
10. Të punësuarit/at e kategorive të mëposhtme përjashtohen nga çfarëdo kërkesë për të dalë në zyrë, qoftë edhe në raste përjashtimi:
- a. Të punësuarit/at **mbi 60 vjeç**;
 - b. Të punësuarit/at me **komplikime shëndetësore** (sëmundje të zemrës, diabet, etj.)
 - c. Të punësuarit/at me **sistem imunitar të dëmtuar**;
 - d. **Gratë shtatëzëna**.

Për të mundësuar punën nga shtëpia, secili/a i/e punësuar lejohet që **të marrë me vete paisjet e nevojshme për punë** (përfshirë kompjuterët, monitorët apo të ngjashme). Për këtë, i/e punësuar/a plotëson formën përkatëse me listën e paisjeve të marra dhe e dorëzon te Zyrtari për TI. Gjithashtu, Zyrtari për TI do të jetë vazhdimisht në dispozicion për **këshilla dhe ndihmë rreth shfrytëzimit të TI** për punë në distancë.

Për të mundësuar komunikimin e vazhdueshëm në distancë, secili/a i/e punësuar pranon një **mbushje telefonike në vlerë prej 5 EUR**, për periudhën deri më 27 mars 2020.

Gjithashtu, të gjithë të punësuarit/at e KCSF-së udhëzohen që:

- **Të anulojnë çfarëdo udhëtimi** brenda dhe jashtë Kosovës, përveç atyre të domosdoshme për të cilat nevojitet leja e qartë e Drejtorit Ekzekutiv;
- **Të shtyjnë çfarëdo takimi** me palë të treta dhe t'i njoftojnë ato për këtë, përveç atyre të domosdoshme shtyrja e të cilave do të shkaktonte probleme serioze për punën e tyre dhe të KCSF-së;
- **Të shtyjnë çfarëdo ngjarje publike** të planifikuar më parë dhe të mos planifikojnë ngjarje publike të paktën deri më 27 mars 2020;
- **Të anulojnë çfarëdo pjesëmarrje** të planifikuar në ngjarje publike të organizuar nga palët e treta dhe për këtë të njoftojnë organizatorët dhe mbikëqyrësi(e)n.

Për shkak që nuk ka ndonjë parashikim të qartë se deri kur do të vlejnjë këto udhëzime, menaxhmenti i KCSF-së do të vlerësojë situatën në baza të rregullta dhe do të përditësojë udhëzimet sa herë që ka nevojë. Në raste jo-urgjente, përditësimet do të ndahen nëpërmjet e-mailit, ndërsa në raste urgjente, nëpërmjet grupit në Viber.

Qëllimi i këtyre masave është që mbi të gjitha të sigurojmë shëndetin dhe mirëqenien e secilit/ës të punësuar dhe bashkëpunëtorë(e)ve të KCSF-së, si dhe të kontribuojmë në masat e përgjithshme për parandalimin e përhapjes së virusit, por duke e ruajtur nivelin e domosdoshëm të punës drejt përmbushjes së misionit dhe obligimeve kontraktuale. Për këtë, dhe duke e njohur faktin që kjo është një situatë unike dhe e paprecedent, e vlerësojmë mirëkuptimin tuaj, përkrahjen në secilën masë dhe angazhimin proaktiv që paralelisht me ruajtjen e shëndetit, të vazhdojmë punën brenda të gjitha mundësive.